



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2020:160616

Datë: 30.05.2024

Numri i dokumentit: 05753694

**C.nr.1005/2020**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, DEGA NË VITI**, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Raif Fazliu dhe bashkëpunëtorin profesional Fitim Limani, në çështjen juridike civile të paditëses, J.S.nga fshati G., Komuna e V., të cilën me autorizim e përfaqëson V.M. avokat në Ferizaj, kundër të paditurve Qeveria e Republikës së Kosovës- Ministria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural (MBPZHR) dhe Komuna e V., Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, për kompensimin e dëmit material, vlera e kontestit 43,000 (katërdhjetë e tre mijë) euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor të mbajtur në praninë e përfaqësuesve të palëve ndërgjyqëse më 20.05.2024, me datë 29.05.2024, përpilon këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. REFUZOHET** e pa bazuar kërkesëpadia e paditëses J.S.nga fshati G., Komuna e V., kundër të paditurve Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Komuna e V., e cila ka kërkuar t'i kompensohet dëmi material në vlerë prej 43,000 €, i shkaktuar nga ngricat e hershme dhe erërat e forta me datë 13.01.2017, me ç'rast ju ishte shkatërruar konstruksioni metalik i serrës dhe perimkultura e marules brenda serrës, për shkak të parashkrimit të kërkesës.

**II.** Secila palë i bart shpenzimet e veta të procedurës.

**A r s y e t i m**

Paditësja, J.S.nga fshati G., Komuna e V., përmes përfaqësuesit të saj, me datë 18.11.2020, në këtë gjykatë, në fillim ka paditur Qeverinë e Republikës së Kosovës, MBPZHR, ndërsa më datë 25.01.2022, padinë e ka zgjeruar në kuptimin subjektiv, duke e paditur edhe Komunën e V. – Drejtorinë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, me të cilën ka kërkuar kompensimin e dëmit material, në vlerë prej 43.000 € (katërdhjetë e tre mijë) euro, i cili i është shkaktuar me datë 13.01.2017, në fidanet të marullës, për shkak të rënieve të temperaturave – ngricave, në pranverën e hershme dhe erës së madhe, e cila i ka shkatërruar edhe konstruksionin metalik dhe folinë e serrës, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e ngritjes së padisë e deri në pagesën përfundimtare, si dhe ka kërkuar shpenzimet e procedurës sipas TOAK-së.

E paditura e parë, Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural, MBPZHR, në përgjigjen e dhënë në padi, duke u bazuar në provat e bashkangjitura, e ka kundërshtuar padinë e paditëses për kompensimin e dëmit, si të pa bazuar, po ashtu ka theksuar se MBPZHR, në ligjin, përkatësisht Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2016, nuk ishte ndarë fond për kompensimin eventual të dëmeve, në sektorin e bujqësisë. Ndërsa lidhur me Raportin vlerësues për dëmin e shkaktuar, i

përpiluar nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural i Komunës së V., ka theksuar se i njëjti nuk mund të prodhojë efekt juridik për paditësen. Ka theksuar gjithashtu se komisioni i formuar nga Komuna e V., ka pasur detyrë vlerësimin e dëmit dhe përpilimin e raportit dhe se i njëjti mund të marrë përgjegjësi vetëm për Komunën dhe ka theksuar se, në bazë të Ligji për Marrëdhëniet Detyrimore, dëmi kompensohet nga ai i cili e shkakton.

Sipas saj, ky raport, nuk përbën dokument përmbarues - titull ekzekutiv, në pajtim me dispozitat nga neni 21 dhe 22 paragrafi 1 pika 1.2, neni 24 paragrafi 1 dhe 3, neni 27 paragrafi i LIGJI NR. 04/L-139 PËR PROCEDURËN PËRMBARIMORE, pasi që nga padia nuk mund të kuptohet kreditori dhe debitori, nuk dihet objekti i përmbarimit, nuk dihet koha e përmbushjes së detyrimit të debitorit ndaj kreditorit, andaj i njëjti është i pa përmbarueshëm dhe nga gjykata ka kërkuar që të refuzohet padia dhe kërkesëpadia e paditëses, Jehona Sylejmani, në mungesë të legjitimitetit real pasiv, në raport me Qeverinë e Republikës së Kosovës – Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Ndërsa, e paditura e dytë Komuna e V. edhe pse në mënyrë të rregullt e kishte pranuar aktvendimin me shkresat e tjera në lënë, ajo përgjigje në padi nuk kishte dhënë.

Gjykata me datë 20.05.2024, ka mbajtur seancën kryesore, ku prezent ishte përfaqësuesi i paditëses, av. V.M., për të paditurën Qeveria e RK-së, MBPZhR ishte prezent Nexhmije Karaqi nga avokatura shtetërore, kurse për të paditurën e dytë, Komuna e V., prezent ishte përfaqësuesi ligjor Ardi Avdiu. Përfaqësuesi i paditëses, av. V. M., ka theksuar se e bën tërheqjen e parashtrësës të dorëzuar me datën 09.01.2024 mbi zgjerimin e kërkesëpadisë në kuptimin subjektiv dhe objektiv sa i përket raportit të datës 18.05.2020. Këtë tërheqje nga ana e përfaqësuesit të paditëses e kishte lejuar gjykata me aktvendimin procedural në seancën e datës 20.05.2024, duke e konsideruar të tërhequr parashtrësën e njëjtë, e cila parashtrësë ishte e bazuar në Raportin e njëjtë për dëmet e shkaktuara nga era dhe bora në serrë me nr. protokollit 10-07/56, i datës 23.01.2017.

Tutje, përfaqësuesi i paditëses deklaroi se mbetet në tërësi pranë thënieve në padi, duke theksuar se nuk është kontestuese se paditëses i është shkaktuar dëmi nga kushtet atmosferike dhe atë në lartësi prej 43,000 euro, duke u bazuar edhe në raportin e vlerësimit të dëmeve i cili është formuar nga komisioni prej 3 anëtarëve profesional nga lëmia përkatëse, pra nga Komuna e V. dhe nga DBPZHR, e i cili raport sipas përshkrimit është formuar, përshkruar drejtuar MBPZHR, raport i datës 23.01.2017, me numër të protokollit 10-07/56. Ka theksuar gjithashtu se për këtë kategori të dëmeve në Komunën e Ferizajt, gjykata i ka aprovuar kërkesëpaditë e të cilat edhe janë vërtetuar nga Gjykata e Apelit. Kurse sa i përket përgjigjes në padi të dhënë nga e paditura e parë, e ka kundërshtuar si të pa bazuar dhe kundërthënës ngase siç ka theksuar nuk qëndrojnë pretendimet se nuk ka buxhet apo linjë të caktuar për kompensimin e këtyre dëmeve. I ka kërkuar shpenzimet e procedurës sipas tarifës së Odes së Avokatëve të Kosovës.

Përfaqësuesja e të paditurës së parë, nga avokatura shtetërore avokatja shtetërore Nexhmije Karaqi ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë kundërshtimeve sikurse në përgjigjen në padi duke e kundërshtuar edhe zgjerimin e kërkesëpadisë. Ka theksuar se bazuar në dispozitat ligjore të LMD-së, kërkesëpadia e paditëses është e parashkruar pasiqë dëmi i cili pretendohet se i është shkaktuar paditëses figuron nga muaji janar 2017, kurse padia është dorëzuar në gjykatë me datën 18.11.2020. Gjithashtu e ka kundërshtuar edhe deklarinimin e përfaqësuesit të paditësit lidhur me vlerësimin si praktikë juridike të Gjykatës Themelore në Ferizaj me numër C.nr.1355/21, të datës 12.10.2022, pasiqë siç ka theksuar e njëjta nuk mund të përdoret si

praktikë gjyqësore. Në fund i ka propozuar gjykatës që të merr aktgjykim me të cilin do ta refuzon kërkesëpadinë e paditëses si të pa bazuar.

Përfaqësuesi ligjor i të paditurës se dytë Ardian Avdiu ka deklaruar se e kundërshton në tërsi kërkesëpadinë e paditëses si dhe precizimin e bërë nga ana e përfaqësuesit të paditëses. Ka theksuar se Komuna e V. nuk ka legjitimitet real pasiv për të qenë palë e paditur pasiqë sipas vendimit të Qeverisë së Kosovës me numër 01/58, i datës 24.07.2018, në asnjë pikë të tij nuk përmendet apo detyrohet Komuna e V. që të bëjë kompensimin për këto lloj dëme, por në atë vendim përmendet vetëm Ministria e Financave dhe MBPZHR. Ka theksuar se thirret edhe në institutin e parashkrimit, ngase siç ka theksuar padia e paditëses është dorëzuar në gjykatë me datën 18.11.2020, kurse e njëjta pretendon se dëmi i është shkaktuar në janar të vitit 2017, andaj sipas dispozitave të LMD-së, ka theksuar se kjo kërkesë është parashkruar. Në fund e ka kundërshtuar edhe raportin e vlerësimit ngase ka theksuar se i njëjti është bërë me kërkesën e palës dhe në asnjë mënyrë nuk e detyron Komunën e V. për kompensimin e këtyre dëmeve.

Përfaqësuesi i paditëses, lidhur me thëniet e të paditurës Komuna e V. është deklaruar se i kundërshton si të pabazuara veçanërisht pretendimin për rrethanën e parashkrimit, pasi që me asnjë provë nuk ka arritur t'a vërtetojnë se kemi të bëjmë me parashkrim, pasi që për raportin e vlerësimit nuk kemi qenë në dijeni dhe me të jemi pajisur vetëm pas kërkesës për dokumentet zyrtare. Raporti na është dorëzuar më datë 03.11.2020 dhe parashkrimi rrjedh nga kjo datë.

Lidhur me deklarin e përfaqësuesve të të paditurave, përfaqësuesi i paditëses ka theksuar se nuk qëndrojnë pretendimet e tyre gjoja se kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesëpadisë nga fakti se paditësja është pajisur me raportin e vlerësimit nga e paditura e dytë dhe atë sipas vendimit të datës 03.11.2020, ashtu që afati i parashkrimit fillon të rrjedh nga kjo datë. Sa i përket legjitimitetit real pasiv të paraqitur nga Komuna e V. nuk është i bazuar ngase raporti për vlerësimin e dëmeve është përpiluar nga komisioni i të paditurës së dytë, dëmet janë shkaktuar në territorin e të paditurës së dytë, po ashtu të drejtat dhe detyrimet burojnë nga ligji për vetëqeverisje lokale ashtu që në anën tjetër Drejtoritë e Komunave janë të ndërlidhura dhe të detyruara ti përgjigjen nivelit qendror.

Meqenëse palët nuk kishin çka të deklarojnë tjetër, gjykata kaloi në administrimin e provave materiale, për të cilat pala paditëse nuk kishte vërejtje, ndërsa pala e paditur, me vërejtje të cilat i kishte theksuar më lartë.

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike kontestimore, gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave:

Raporti për vlerësimin e dëmeve i protokolluar me datën 23.01.2017, nga ana e Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, me numër 10, drejtuar MBPZHR, ndërsa i protokolluar me datën 23.01.2017, nga Komisioni prej 3 anëtarëve.

Lista e hartuar nga Komuna e V., me 28 emra të personave bazuar në kërkesën e avokatit V.M., të cilën listë me anë të vendimit me numër 04-035/02-98.

Vendimi me numër 01/58, i dates 24.07.2018, i nxjerrur nga ish Kryeministri Ramush Haradinaj.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitën e nenit 8 të LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridike civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

-Nga raporti për vlerësimin e dëmeve i protokolluar me datën 23.01.2017, nga ana e Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, me numër 10, drejtuar MBPZHR, ndërsa i protokolluar me datën 23.01.2017, nga Komisioni prej 3 anëtarëve, gjykata ka vërtetuar faktin se me datën 13.01.2017, në Komunën e V., ka pasur fryrje të erës me shpejtësi të madhe dhe reshje të mëdha të borës ku është shkaktuar dëmi në serra duke dëmtuar gjithë konstruksionin metalik dhe gjithë foline në serrën prej 0.20/ha, e cila evidentohet në emër të tani paditëses Jehona Sylejmani.

-Nga Lista e hartuar nga Komuna e V., me 28 emra të personave bazuar në kërkesën e avokatit V.M., të cilën listë me anë të vendimit me numër 04-035/02-98, gjykata ka vërtetuar faktin se Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në Komunën e V. bazuar në kërkesën për qasje në dokumente publike, ka dorëzuar listën me emrat e 28 fermerëve nga Komuna e V. të cilët në vitin 2017, kanë pësuar dëme si pasojë e ngricave dhe reshjeve atmosferike. Sipas të njëjtës listë, tani paditësja figuron me numër rendor 11.

-Nga Vendimi me numër 01/58, i dates 24.07.2018, i nxjerrur nga ish Kryeministri Ramush Haradinaj, gjykata ka vërtetuar faktin se me datën 24.07.2018, Qeveria e Kosovës kishte nxjerrur vendim për kompensimin e menjëhershëm të dëmeve të shkaktuara nga breshëri në Komunitat e Kosovës, për periudhën e vitit 2019, mirëpo duke mos përmendur asnjë Komunë përkatëse.

LIGJI NR. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, gjegjësisht neni 136 mbi bazën e përgjegjësisë, në paragrafin 1, thuhet se *“Kush i shkaktonte tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”*. Ndërsa bën përkufizimin se *“Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material)”*.

Në nenin 173 paragrafi 1, thuhet se *“I dëmtuari ka të drejtë si për shpërblimin e dëmit të rëndomtë, ashtu edhe për shpërblimin e fitimit të humbur”*.

Po ashtu, i paqëndrueshëm është pretendimi i palës paditëse se Raportin e Vlerësimit të dëmit me numër 10, i dates 23.01.2016, e obligon të paditurën e dytë, Komunën e V., për zhdëmtimin e dëmit të shkaktuar tek paditësja, ngase i njëjti raport në asnjë pikë të tij nuk e detyron Komunën e V. që të bëjë asnjë lloj kompensimi për tani paditësen, por raporti i njëjtë është përpiluar vetëm me kërkesën e tani paditëses dhe gjykata e ka marrë si të mirëqenë deklarinimin e përfaqësuesit ligjor të Komunës së V. i cili në seancën e shqyrtimit kryesor ndër të tjera ka theksuar se *“Komuna vetëm i është përgjigjur një kërkesë të një qytetari”*, andaj gjykata vlerëson se ky raport më tepër është përgjigje në kërkesën e tani paditëses për dëmin e shkaktuar në serrën e saj sesa obligim për të paditurën e dytë Komuna e V..

*Vlerësimi përfundimtarë i gjykatës*

Nga faktet e administruara, pretendimet e palëve ndërgjyqëse dhe bazës ligjore të cekur më lartë, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është e pa bazuar.

Çështjet kryesore për gjykatën në këtë lëndë ishte përgjegjësia e të paditurave për kompensimin e dëmit. Për të paditurën e parë, përgjegjësia për kompensimin e dëmit, për të paditurën e dytë ishte çështja e legjitimiteti juridik real pasiv, në këtë çështje juridike civile, si dhe nëse kërkesa e paditëses ishte parashkruar dhe se pas analizimit dhe vlerësimit të fakteve, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është e pa bazuar në ligj dhe fakte.

Pala paditëse, pretendimin e saj, për kompensimin e dëmit e kishte mbështetur në raportin për vlerësimin e dëmeve i protokolluar me datën 23.01.2017, nga ana e Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, drejtuar MBPZHR, ndërsa i protokolluar me datën 23.01.2017, nga Komisioni prej 3 anëtarëve, ku Komuna e V., sipas kërkesës me numër 10-16/1629, të dates 16.01.2017, nga ana e tani paditëses Jehona Sylejmani, kishte nxjerrur raport vlerësimi për dëmin e shkaktuar me datën 13.01.2017, në fshatin G., Komuna e V. si rezultat i kushteve atmosferike, mirëpo ky raport në asnjë pikë të tij nuk e detyron Komunën e V., tani të paditurën e dytë që të bëj asnjë lloj kompensimi për paditësen Jehona Sylejmani, mirëpo në atë raport vetëm është përshkruar gjendja faktike se çka ka ndodhur me datën e lartcekur në serrën e lartcekur.

Gjykata, po ashtu, pretendimin e palës paditëse se Vendimi me numër 01/58, i dates 24.07.2018, i nxjerrur nga ish Kryeministri Ramush Haradinaj, me te cilin vërtetohet se me datën 24.07.2018, Qeveria e Kosovës kishte nxjerrur vendim për kompensimin e menjëhershëm të dëmeve të shkaktuara nga breshëri në Komunitat e Kosovës, për periudhën e vitit 2019, mirëpo duke mos përmendur asnjë Komunë përkatëse. Për gjykatën, ky fakt nuk ishte provë relevante dhe nuk e bënë bindës pretendimin e palës paditëse se, Qeveria e Kosovës, gjegjësisht, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural është përgjegjëse për kompensimin e dëmit të shkaktuar të paditurit, nga kushtet atmosferike me datën 13.01.2017. Kjo për faktin se, ky vendim kishte të bëj me kompensimin e menjëhershëm të dëmeve të shkaktuara nga breshëri, në komunitat e Kosovës dhe ishte autorizuar Ministria e Financave, për krijimin e një fondi të veçantë, për vitin 2019, për kompensimin e dëmeve eventuale në sektorin e bujqësisë, por se ky vendim nuk krijon detyrime për Qeverinë e Kosovës, gjegjësisht, Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, për kompensimin e dëmit të paditëses të shkaktuar me datën 13.01.2017. Pra ky vendim në asnjë mënyrë nuk e obligon Qeverinë e Republikës së Kosovës, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, pasi që ky vendim nuk kishte të bëj fare me rastin konkret. Po ashtu ky vendim, në asnjë mënyrë nuk e obligon Komunën e V., gjegjësisht, Drejtorinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, pasi siç u theksua më lartë, ky vendim ka krijuar obligime për kompensimin e dëmeve eventuale në sektorin e bujqësisë, për periudhën kohore të vitit 2019 dhe jo për periudhën e vitit 2017.

Gjykata, po ashtu, erdhi në përfundim se kërkesa e paditëses është e parashkruar, për faktin se sipas nenit 357, për kërkesën e shpërblimit të dëmit, në paragrafin 1 thuhet, se *“Kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar parashkruhet për tri (3) vite nga data kur i dëmtuari ka marrë dijeni për dëmin dhe për personin, i cili e ka shkaktuar dëmin”*. Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja padinë e ka ushtrua në 18.11.2020, ndërsa dëmi, të njëjtit i është shkaktuar me datën 13.01.2017, d.m.th. në një periudhë kohore më të gjatë se 3 vjetë e dhjetë muaj.

Arsyetimi i palës paditëse me pretendimin se parashkrimi lidhur me këtë çështje duhet të filloj nga data kur paditësi e ka marrë Raportin e Vlerësimit, për të cilin si provë ka propozuar Vendimin për qasje në dokumentet zyrtare nr.04-035/02-1058 të datës 04.11.2020, ku vërtetohet se Komuna e V., me datë 03.11.202, duke vepruar sipas kërkesës së av. Visar

Musa, ka aprovuar kërkesën e të njëjtit për qasje në dokumentet zyrtare, në emër të palës së dëmtuar Jehona Sylejmani, nga fshati G., Komuna e V. nuk e konsideron relevant për këtë çështje dhe nuk përbën arsye për mos fillimin e rrjedhjes së afatit të parashkrimit, pasi që në nenin 357 decidivisht është theksuar se “*Kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar parashkruhet për tri (3) vite nga data kur i dëmtuari ka marrë dijeni për dëmin dhe për personin, i cili e ka shkaktuar dëmin*”, dhe paditësja për dëmin ka qenë e njoftuar ditën që i është shkaktuar i njëjti, ndërsa vlerësimi për dëmin, gjegjësisht Raporti i vlerësimit mund të prezantohej si provë gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes.

Sa i përket pretendimit të paditurës, Komuna e V., se nuk ka legjitimitet juridik real pasiv, për të qenë e paditur, gjykata e konsideron si të bazuar. Sepse, mbështetur në vendimin e Qeverisë nr.01/58 të datës 24.07.2014, në asnjë pikë të dispozitivit të këtij aktvendimi nuk autorizohet apo detyrohet Komuna e V., për kompensimin e dëmeve, që do të thotë se përgjegjëse për kompensimin e dëmit është MBPZhR, në këtë vendim është saktësuar se detyrimet krijohen vetëm për kompensimin e dëmeve eventuale në sektorin e bujqësisë, për periudhën kohore të vitit 2019 dhe jo për periudhën e vitit 2017, me çka në asnjë mënyrë nuk bëhet përgjegjëse Komuna e V..

Gjykata konstaton se paditësja e ka humbur të drejtën e kërkesës së përmbushjes së detyrimit kompensues përmes padisë, për shkak të parashkrimit të kërkesës. Ky konstatim bazohet në thirrjen e vazhdueshme të palëve të paditura, duke e cituar edhe nenin 357 të Ligjit për Marrëdhëniet Detyrimeve (LMD), Ligji Nr.04/L-077, andaj në rastin konkret paditësja ka humbur mundësinë e realizimit të kërkesës përmes gjykatës.

Vendimin që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta të procedurës gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore konform nenit 450 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, pasi që paditësja e ka humbur kontestin, ndërsa të paditurat nuk i kanë kërkuar shpenzimet.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Themelore në Gjilan - Dega në Viti  
C.nr.1005/2020, më datë 20.05.2024

G j y q t a r i  
Raif Fazliu

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.